



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 2675/2026  
Data: 23.03.2026

### PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e dytë -II-për vitin 2026 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 24.03.2026 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Prezent ishte **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), **Bashkim Sopa** (Zyrtari për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Drejtoreshën e Administratës.
3. Takim me Drejtoreshën e Shëndetësisë.
4. Takim me Udhëheqësin e Qendrës për Punë Sociale.
5. Identifikimi dhe parandalimi i dukurive negative në Komunën e Han të Elezit.
6. Eventuale.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Takim me Drejtoreshën e Administratës.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson: e kemi përcjellë planin e punës dhe raportin e punës në kuvend, që do të trajtohen. Punët të cilat i kryen drejtorja e administratës janë: pjesa e sektorit të gjendjes civile, pjesa e shërbimeve me qytetarët, pjesa e depove - materialeve logjistike, sektori i autoparkut, arkiva dhe transparenca, si dhe sektori i cili merret me mirëmbajtjen e komunës dhe pjesa e teknologjisë informative. Gjatë vitit 2025 kemi bërë aktivitete të ndryshme, trajnime, takime të ndryshme dhe po ashtu është bërë edhe renovimi i qendrës për shërbim me qytetarë, pra është bërë një ndryshim drastik, sepse qendra për shërbim për qytetarë është pasqyrë për komunën. Është bërë furnizimi me pajisje teknologjike për zyrtarët e qendrës për punë sociale dhe për zyrtarët e tjerë brenda komunës. Ajo që vlerësohet shumë që nga fillimi i kësaj qeverise është transmetimi i seancave llajv, seancave të kuvendit të komunës. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim, mund të parashtroni.

**Sead Vila** thekson: edhe pse është fillimi, mendoj që qëllimi i përbashkët është me punuar, pavarësisht vijave ndarëse që vijnë prej subjekteve të ndryshme. Si anëtar i këtij komiteti, kërkoj që me pasur objektivitet, paanshmëri, pavarësisht kategorisë së personave që i kemi, shërbimet duhet të jenë në përputhje me ligjin e jo me pasur anime apo forma të përjashtimeve. Është mirë të punohet në dobi të qytetarëve, sepse përkrahjen në kuvend do ta keni.

**Kryesuesi** thekson: debatet publike, të cilat po mbahen me qytetarë, prezenca është e vogël. A keni menduar me bërë diçka në këtë drejtim, se çdo herë ka qenë keq? Ka shqetësime të qytetarëve, të cilat potencojnë se nuk e dinë adresën se ku me u drejtuar.

**Natyra Kalisi** thekson: komuna jonë nuk punon me anime, sepse të gjitha shërbimet të cilat i japin zyrtarët i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi. Nëse krahasohet me vitet paraprake, është ngritur pjesëmarrja publike. Nëse krahasohet transparenca e përgjegjshmërisë komunale me vitin 2024, i ka 43.08 %, e që i bie që është në top dhjetë komunat e Kosovës që e ka përgjegjshmërinë komunale në aspektin kohor. Në bazë të udhëzimit administrativ për komunat e hapura, parashihet që dy javë të bëhet njoftimi publik, por ndoshta do të ishte mirë me ngritur si çështje me secilin prej neve, apo edhe akterët kryesorë, siç jemi ne dhe ju, me u bashkangjitur në këto thirrje. Ne e kemi planin për transparencë, që në këtë vit duhet të ripërtërihet. E kemi edhe strategjinë për komunikim për pjesëmarrje të qytetarëve, për të cilën kemi bërë disa fletushka, në mënyrë që qytetarët si me bërë kërkesa dhe ankesa e si me iu qasë platformës digjitale. Janë platformat publike në të cilat ne i publikojmë këto draft dokumente dhe mund t'i gjejmë.

**Kryesuesi** thekson: shoh shumë persona të cilët japin kritika nëpër kafe, por nuk marrin pjesë nëpër dëgjime publike. Komuna i jep njoftimet me kohë.

**Ibadete Kuka** thekson: a keni bërë ndonjë plan për tabelat digjitale informuese, për me i vendosur edhe dikund tjetër?

**Natyra Kalisi** thekson: e kemi pasur një projekt shumë të mirë me Këshillin e Evropës, që ka pasur me vendosur një tabelë digjitale te pjesa e udhëkryqit që është në Han të Elezit, që kanë pasur komplet njoftimet për me u publikuar, por për shkak se është neglizhuar puna prej zyrës së prokurimit edhe prej menaxherit të kontratës, procedura nuk ka mundur me u zhvilluar me sukses dhe operatori ekonomik i cili e ka fituar tenderin ka dështuar me sjellë pajisjen, mirëpo edhe pajisjen të cilën ka dashur me sjellë nuk është pranuar, për shkak se ka qenë jashtë specifikave të kontratës të cilën e ka ofertuar. Ka qenë me u përfunduar deri më datë 31.12.2025. Ne kemi kërkuar edhe afat shtesë prej Këshillit të Evropës dhe na ka ofruar afatin shtesë, por Operatori ekonomikë nuk ka bërë hapa të tjerë. Por secila mundësi që na jepet, kjo është shumë e mirë, për shkak se e rrit transparencën dhe në strategjinë për komunikim me qytetarë e kemi pasur si synim që me i vendosur dy tabela digjitale nëpër zonat ku ka frekuentim të qytetarëve, por do të shikohen mundësitë përmes donacioneve.

**Sead Vila** thekson: çështja e konkurseve, a është sistem që aplikohen në të gjitha komunat, se është pak procedurë e vështirë për qytetarët? A ka ndonjë mundësi më të drejtë për drejtë?

**Natyra Kalisi** thekson: në bazë të ligjeve është platforma dhe konkurset, përveç që publikohen në platformën kryesore, të njëjtat publikohen edhe të faqja zyrtare e komunës, të gjitha konkurset dhe njoftimet. Por tash mënyra e aplikimit është bërë në mënyrë digjitale për zyrtarët, ndërsa për arsim dhe shëndetësi duhet me i sjellë dokumentet në kopje fizike. Kjo është e rregulluar me ligj.

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 3. Takim me Drejtoreshën e Shëndetësisë.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kimete Kuka-Hasallari** thekson: kjo drejtori ka për obligim performancën e aktiviteteve të cilat janë në kuadër të drejtorisë, që është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendra për Punë Sociale. Në kuadër të QKMF-së e kemi edhe AMF-në në fshatin Gorancë, që funksionon dy herë në javë. QKMF e ka një punë njëzet e katër orëshe, që është mjekësia familjare dhe urgjenca. Në kuadër të mjekësisë familjare janë edhe sektorët e tjerë të cilët japin shërbime, që është sektori i imunizimit dhe sektori i shëndetit publik, sektori i stomatologjisë, që realisht është funksionalizuar në këto katër vite, sektori i diagnostikës, i cili përfshin rëntgenin dhe laboratorin, sektori i administratës. Pra, janë këta sektorë të cilët e bëjnë funksionale QKMF-në për këto shërbime të cilat i kemi për qytetarët. Gjatë mandatit katër vjeçar jemi munduar me ofruar shërbime shëndetësore edhe jashtë asaj që e kemi pasur obligative, e që në bashkëpunim me kompaninë "Sharrcem" me dhënë shërbime tjera profesionale, siç është kardiologu, për të cilin na ka mbështetur Sharrcemi. Para se me funksionalizuar sektorin e stomatologjisë, na ka mbështetur Sharrcemi për stomatologun. Kemi pasur shërbime pulmologjike gjatë vitit të kaluar dhe kemi me u munduar që së paku për këto katër vitet e ardhshëm me pasur edhe profesionistë të tjerë shëndetësorë.

**Kryesuesi** thekson: rekomandoj që me i shikuar mundësitë edhe prej komunës që me pagesë puna e pulmologut me vazhduar. Vij prej lëmisë së arsimit dhe e kam vërejtur që nga klasa një deri në pesë problem po kanë me dhëmbët dhe është mirë që në të ardhmen me i bërë do kartona që për secilin fëmijë me ia bërë gjendjen stomatologjike.

**Kimete Kuka-Hasallari** thekson: si QKMF nuk kemi kompetencë që me pasur kartona të veçantë, pavarësisht se obligim e kemi për me i pasur kontrollet sistematike për çdo vit së bashku me stomatologun dhe janë kryer për tre vite me radhë, pastaj vjen një raport i përgjithshëm i mjekëve që kanë qenë pjesë e këtyre kontrolleve dhe i përcillet drejtorit të shkollës fillore dhe i rekomandohet se cilët fëmijë kanë nevojë për ndërhyrje, qoftë për te stomatologu, qoftë edhe për ndonjë kontroll tjetër specialistik, për të cilin njoftohen edhe prindërit. Për specialistët e tjerë, si pulmologjia, si QKMF nuk e kemi ligjërisht për me pasur, sepse janë të specifikuar se cilat shërbime shëndetësore janë në nivel parësor.

**Erblin Meliqi** thekson: në QKMF ka mungesë të stafit. Për vitin 2026, a do të ndërmerret ndonjë hap për me pranuar staf të ri, se në legjislaturën e kaluar është ndërruar statuti i QKMF-së dhe përfshihen pozita të lira? A do të plotësohen brenda vitit 2026?

**Kimete Kuka-Hasallari** thekson: në mandatin e kaluar vazhdimisht sfidë më e madhe ka qenë mungesa e stafit dhe vazhdimisht kemi parashtruar kërkesë në Ministri për rritjen e stafit. Jemi munduar që përmes organizatave me shtuar numrin e stafit, por nuk kemi pasur mbështetje. Në vitin e kaluar, me qarkoren e parë buxhetore, na është konfirmuar se do t'i keni trembëdhjetë pozita, por për me funksionuar normalisht është dashur që së paku njëzet e dy pozita minimumi me na i pas aprovuar. Për vitin 2026 jemi në proces, por nuk është bërë koordinimi i sistemit në mënyrë që me i hapur pozitat, sepse nevoja është urgjente. Unë përsëri do të vazhdoj me kërkesa në Ministrinë përkatëse për shtimin e stafit.

**Sead Vila** thekson: çdo herë e kam pasur si shqetësim, por edhe kur kam qenë asamblist, çështjen e barnave. A është gjendja më e mirë, a ju ndahen atyre që kanë nevojë? Më herët kanë qenë disa analiza që janë kryer pjesërisht e disa nuk janë kryer. A janë shumica e analizave të gjakut të kompletuara apo ka edhe analiza që nuk bëhen? Si mësimdhënës, kur isha, nxënësit shumë na kanë sjellë vërtetime. A kontrollohen apo vetëm u jepen nxënësve? Sepse ata fëmijë që kanë qenë të sëmurë në vetë i kemi liruar, por ka fëmijë që ka marrë për dy apo tri ditë vërtetim dhe rri nëpër kafiteri e nuk vjen në shkollë.

**Kimete Kuka-Hasallari** thekson: sa i përket barnave, është lista esenciale që ekziston, e cila aprovohet zakonisht prej Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe pse ato po thirren që e kemi zgjeruar listën, si drejtoreshë e kam vërejtur se ka mungesë të barnave. Në momentin që nuk janë ato barna dhe mungojnë nga lista esenciale, zakonisht e bëjmë kontratë të veçantë me operatorë të tjerë ekonomikë që me na furnizuar në momentin kur janë në mungesë atje. Te shpërndarja nuk kemi ndonjë kontroll të veçantë, por çdo kush që merr shërbime aty duhet me u furnizuar me barna të cilat janë aty. Nuk mundem me paragjykuar, por në momentin që keni ndonjë rast që dikujt i është dhënë e dikujt jo, atëherë është mirë me parashtruar ankesë me shkrim. Përveç analizave bazike që i kemi pasur, jemi duke u munduar me u furnizuar me material laboratorik, por pengesa më e madhe është kur bëhet përmbushja e kontratës dhe po na zgjat shumë deri sa po lidhim kontratë të re me kompaninë. Deri në dhjetë mijë euro i kemi për çdo vit, por kam tentuar që kontrata të jetë dy vjeçare, që së paku mos me pasur probleme në fillim të vitit apo në fund të vitit.

**Ibadete Kuka** thekson: a është e përcaktuar se sa persona kanë me i bërë analizat apo varet sa ka material?

**Kimete Kuka-Hasallari** thekson: nuk ka ndonjë numër të caktuar, por të paktën ata pacientë që kërkojnë shërbime për atë ditë kryhen. Është në mungesë vetëm në ato raste kur na përfundon kontrata.

**Kryesuesi** thekson: në Facebook e pashë një postim të z. Avdulla Idrizi, i cili kishte bërë një postim për ambulancën, i cili potencon se: “dua të falënderoj të gjithë stafin e QKMF-së në Han të Elezit për shërbimin që ma kanë bërë në rastin e nënës sime, kam shumë fjalë të mira për stafin në përgjithësi dhe nuk di si të falënderoj”. Kjo ishte një lëvdatë dhe unë u ndjeva shumë krenar si banor i Hanit të Elezit, sepse dihet që Lagjja Kashan është me Kaçanik. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

#### 4. Takim me Udhëheqësin e Qendrës për Punë Sociale.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Amir Bushi** thekson: aktualisht funksionojmë me dy shërbime: shërbimi i skemës sociale dhe shërbimet sociale. Në kuadër të skemës sociale janë ndihmat sociale që menaxhohen prej neve, por paguhen nga Ministria drejt për drejt, ndërsa shërbime sociale i ofrojmë ne.

**Ibadete Kuka** thekson: a ka ndodhur ndonjë rast që i kanë braktisur fëmijët dhe, nëse ka ndonjë rast, çka është bërë me atë fëmijë?

**Amir Bushi** thekson: nëse ka raste, fëmijën e merr Qendra për Punë Sociale dhe e dërgon në spital. Raste kemi pasur dhe fëmijën e kemi dërguar te familjet strehuese. Interesi më i madh i qendrës është që fëmijën me e bashkuar me prind apo me anëtarë të tjerë përreth. Nëse shterren mundësitë, i marrim të gjitha deklaratat në mënyrë që atë fëmijë me e dërguar në familje strehuese.

**Sead Vila** thekson: më herët ka pasur mbi 200 përfitues të skemës sociale, ndërsa tash janë 76 familje dhe është pozitive që qytetarët mu orientuar te Qendra për Punë Sociale, sepse është e pamjaftueshme për me ia dalë. Në të kaluarën kemi pasur raste që dikush ndoshta nuk ka qenë për social, por i është dukur një mbështetje për shkak se është mësuar në atë formë. Është mirë që në komunën tonë nuk ka numër të madh.

**Kryesuesi** thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës

## 5. Identifikimi dhe parandalimi i dukurive negative në Komunën e Han të Elezit.

**Kryesuesi** thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.


**Sead Vila** thekson: dukuritë negative janë prezentë, diku më pak e diku më shumë, por është mirë që, në bazë të përgjegjësive që i kemi, të ndikojmë duke filluar nga fëmijët tanë, familja dhe rrethi ku jetojmë. Numri i madh i lypësve është rritur dhe asnjë nuk është prej Hanit të Elezit. Është mirë që të paraqitet si shqetësim në organet përkatëse.

## 6. Eventuale

**Kryesuesi** thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 14:45.

**Procesmbajtësi**  
**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Komitetit**  
**Basri Derjani**

